

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**  
**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**  
**GJUHË SHQIPE**  
**për klasën III**

**Shkup, 2022**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	<b>Gjuhë shqipe</b>
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	E detyrueshme
<b>Klasa</b>	III (e tretë)
<b>Tema/fusha programore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Të dëgjuarit dhe të folurit</b></li> <li><b>2. Të lexuarit dhe të shkruarit</b></li> <li><b>3. Letërsi, të shprehurit dhe krijimtaria</b></li> <li><b>4. Njohuri mediatike dhe kulturë e medias</b></li> </ol>
<b>Numri i orëve</b>	5 orë në javë / 180 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• tablet, kompjuter, përforcues zëri, kufje;</li> <li>• tabelë e mençur;</li> <li>• lapustila (markera) shumëngjyrësh;</li> <li>• fletëza mësimore, plakate, afishe, ilustrime me figura (të ndara ose në varg) që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë;</li> <li>• libra (me tregime të shkurtra, përrallëza, përralla, vjersha, gjëza, fjalë të urta);</li> <li>• revista për fëmijë, enciklopedi me ilustrime për fëmijët, fjalorë të ilustruar;</li> <li>• bibliotekë digjitale me libra;</li> <li>• bibliotekë me libra në klasë;</li> <li>• filma të animuar, regjistrime audio-vizuale shfaqjesh teatrale, softuerë mësimorë nga interneti dhe mjete të tjera audio-vizuale, si dhe mjete të tjera varësisht nga qëllimi mësimor.</li> </ul>
<b>Normativi për kuadrin mësimor</b>	Punën edukativo-arsimore për klasën e tretë mund ta zhvillojë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• profesori/arsimtari/mësuesi i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS;</li> <li>• pedagogu i diplomuar VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS.</li> </ul>

## NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëputë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medime të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura**

<i>Nxënësi /nxënësjja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimi e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të silltet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjyqimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe 5 vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore.

<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënësit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

## REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT**

Gjithsej: **40 orë**

### Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë një tekst të dëgjuar: të identifikojë dhe të përshkruajë të dhënat themelore (pjesëmarrësit/personazhet, përshkrimet, vendndodhjet, kohët), të bëjë përmbledhjen (rezymenë) e tekstit, t'u përgjigjet pyetjeve dhe të parashtrojë pyetje rreth tekstit;
2. të marrë pjesë në një bisedë duke shprehur një mendim, duke bërë pyetje dhe duke iu përgjigjur pyetjeve;
3. të përdorë intonacionin e duhur dhe shqiptimin e drejtë gjatë të folurit;
4. të rrëfejë dhe të përshkruajë, duke e ndryshuar pozicionin e rrëfimitarit;
5. të ritregojë e të tregojë duke i përdorur si duhet kohët e foljeve (të tashmen, të kryerën e thjeshtë dhe të pakryerën), si dhe ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë.

### Përmbajtjet (dhe konceptet):

- **Të dëgjuarit me të kuptuar**

### Standardet për vlerësim:

- Identifikon personazhet në tekstin e dëgjuar dhe përcakton se sa personazhe janë, kush (dhe kur) flet dhe si flet (me zë të ulët, me zë të mesëm ose me zë të lartë).
- Identifikon numrin e fjalive që përmban teksti duke dëgjuar tekstin (më së shumti pesë fjali).
- Përshkruan vendet, vendndodhjet, pamjen e sendeve dhe të personave sipas përmbajtjes së tekstit të dëgjuar.
- Bën përmbledhjen (rezymenë) e përmbajtjes së tekstit që dëgjon (me gojë dhe me shkrim).
- Identifikon dhe tregon të dhëna për kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprimit në tekstin që dëgjon.
- Përshkruan (me gojë ose me shkrim) veçoritë e personazheve, objekteve dhe të dukurive në tekstin që dëgjon.
- Identifikon gjërat e palogjikshme në tekstin që dëgjon.
- U përgjigjet llojeve të ndryshme të pyetjeve (pyetje të tipit *po/jo*; pyetje të tipit *kush/çfarë*; pyetje të tipit *ku/kur*; pyetje të tipit *pse*) në lidhje me përmbajtjen që dëgjon.
- Parashtron lloje të ndryshme të pyetjeve (pyetje të tipit *po/jo*; pyetje të tipit *kush/çfarë*; pyetje të tipit *ku/kur*; pyetje të tipit *pse*) në lidhje me përmbajtjen që dëgjon..
- Identifikon fjalët e panjohura në tekstin që dëgjon dhe me fjalët e veta përshkruan kuptimin e tyre.

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të folurit me të kuptuar</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor në mënyrë adekuate fjalitë e dëgjua në situata të ndryshme komunikimi të përditshëm në kontekste të ndryshme.</li> <li>• Shpreh gojarisht mendimin e tij për një situatë të caktuar problemore nga jeta e përditshme.</li> <li>• Tregon gojarisht një ndodhi nga përvoja e tij/e saj sipas radhës (kronologjisë) së ngjarjeve.</li> <li>• Përdor fjalë të reja gjatë të shprehurit me gojë në përputhje me temën ose situatën e komunikimit.</li> <li>• Përshtat tonin, intonacionin dhe mënyrën e të folurit sipas situatës së komunikimit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shqiptimi</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan në rrokje në mënyrë të pavarur fjalët shumëërrokëshe.</li> <li>• Identifikon fjalët e shqiptuara gabim dhe i shqipton saktë.</li> <li>• Përdor intonacionin e duhur kur thotë fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, thirrmore dhe nxitëse.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ritregimi me gojë, tregimi dhe përshkrimi duke përdorur si duhet kohën e tashme, kohën e kryer të thjeshtë dhe të pakryerën</b> (pa përkufizimin e tyre)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon gojarisht ngjarje dhe ndodhi nga përditshmëria duke përdorur kohën e tashme të foljes.</li> <li>• Ritregon duke përdorur saktë fjalitë në kohën e pakryer.</li> <li>• Ritregon ngjarje dhe ndodhi nga jeta e përditshme duke përdorur kohën e kryer të thjeshtë.</li> <li>• Tregon një histori të shkurtër të bazuar në një seri fotografish duke u vënë në rolin e rrëfyesit dëshmitar.</li> <li>• Tregon një ngjarje/ndodhi në rolin e personazhit kryesor, duke e paraqitur në mënyrë kronologjike dhe duke i përdorur drejt kohët e foljeve.</li> <li>• Tregon rreth një teme të caktuar ose një teme të zgjedhur, duke përdorur fjalorin e duhur dhe duke i përdorur foljet në kohën e tashme dhe në të shkuarën.</li> <li>• Përshkruan njerëz, personazhe, bimë, kafshë, dukuri natyrore, peizazhe, duke i përdorur si duhet emrat, mbiemrat, përemrat dhe numërorët.</li> <li>• Riformulon format e dialogut në ligjëratën e zhdrejtë, duke përdorur fjali të ndryshme për nga përmbajtja (fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, thirrmore, nxitëse, pohore, mohore (-<i>Drita, të lutem, ma jep librin!</i> – <i>Prit ta përfundoj detyrën, Besnik!</i> / <i>Besniku i kërkoi Dritës t'ia jepte librin. Drita i tha që të priste ta përfundonte detyrën.</i>).</li> <li>• Riformulon fjalitë me qëllime komunikuese të ndryshme nga ligjëratat e zhdrejtë në dialog: (<i>Mësuesja na pyeti se kur do të largoheshim. Ne i thamë se kishim edhe pak për të shkruar. – Kur do të largoheni, nxënës? - na pyeti mësuesja.; - Kemi edhe pak punë, mësuese, -iu përgjigjëm ne.</i>).</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit dëgjojnë paralajmërimin për një serial të famshëm të animuar për fëmijë ose një reklamë për ushqim të shëndetshëm dhe identifikojnë se për cilin serial/reklamë bëhet fjalë, i njohin personazhet, zbulojnë sa janë dhe kush janë ata, nëse flasin me zë të lartë, të qetë a të mesëm.</li> </ul>	

- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër (më së shumti me 5 fjali) me informacione duke pasur për detyrë të kenë kujdes se sa fjali përmban teksti. Kur e dëgjojnë sërish këtë tekst, ata thonë me zë të lartë “pikë” gjithmonë kur ata e mendojnë se fjalia ka përfunduar (varësisht nga kuptimi i fjalisë dhe intonacioni gjatë leximit). Në fund, mësimitdhënësi i lexon fjalitë një nga një, kurse nxënësit i shkruajnë ato.
- Nxënësit e ndarë në grupe dëgjojnë një tekst rreth vizitës në një qytet. Rrëfimtari (narratori) jep informacione për vendin dhe pamjen e tij, për disa objekte si dhe për disa njerëz që jetojnë aty. Pasi e dëgjojnë, me ndihmën e disa pyetjeve të dhëna, secili grup bën nga një përshkrim të shkurtër të vendeve, lokacioneve, objekteve dhe njerëzve në bazë të përmbajtjes që ka dëgjuar.
- Nxënësit dëgjojnë një fragment të shkurtër nga biografia e një muzikanti/e, artist i/e, sportisti/e të njohur, kurse pastaj diskutojnë rreth përmbajtjes. Përmbajtjen e përmbledhur e shkruajnë me disa fjali të shkurtra.
- Nxënësit dëgjojnë një fabul, kurse mësimitdhënësi i udhëzon se si ta përcaktojnë kohën, vendin dhe mënyrën si zhvillohet veprimi në tekstin që e dëgjojnë. Mandej, të ndarë në grupe, i thonë/prezantojnë të dhënat për kohën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimit, të cilat i kanë identifikuar brenda tekstit.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla /çifte. Secili grup/çift merr nga një zar – te secila faqe e zarit paraqitet nga një personazh/objekt/kafshë dukuri nga tregimi që kanë mësuar më herët. Zarin e hedh secili nxënës i grupit dhe bën identifikimin, emërtimin dhe përshkrimin e asaj që i ka rënë në faqen e zarit.
- Nxënësit luajnë lojën *Fjalitë e përmbysura*. Mësimitdhënësi u lexon një tekst me fjali të logjikshme dhe të palogjikshme, si p.sh.: *Binarët ecin pas trenit. Sokoli dhe Zana shikojnë prej njëres dritare të trenit. Kodrën po shikonte dhe e përshëndeti Zana. Treni mbërriti në stacion. Disa udhëtarë hynin, kurse disa të tjerë dilnin nga dyert e trenit. Valixhen e tij mori Sokoli dhe e përshëndeti Zanën.* Nxënësit i gjejnë pjesët e palogjikshme, i shkruajnë fjalitë drejt dhe komentojnë se pse duhet të shkruhen ashtu.
- Nxënësit dëgjojnë një rrëfim dhe pastaj u përgjigjen pyetjeve të tipit: *A kishte personazhe kafshë në tekst? Cili ishte, sipas jush, personazhi kryesor? Për çfarë bëhet fjalë në tekst? Çfarë i ndodhi në fund personazhit kryesor? Ku ndodhi ngjarja? Kur ndodhi ngjarja? Përse u shfaq problemi në tekst?*
- Nxënësit ndahen në grupe. Mësimitdhënësi lëshon një audio regjistrim (fjalë që shprehin mirënjohje, ngushëllim, falje, miratim/komplimente, dëshira, kërkesa, biseda telefonike, dialogë dhe monologë të incizuar etj.). Nxënësit diskutojnë në grupe për situata të përditshme komunikimi. Secili grup prezanton para klasës pikëpamjet e veta dhe diskutojnë duke parashtruar pyetjet e tipit: *po/jo, kush/çfarë, ku/kur, pse*) që lidhen me përmbajtjen e dëgjuar.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst dhe sa herë që hasin ndonjë fjalë të panjohur në tekst thonë me zë të lartë “STOP”. E përmendin fjalën e panjohur, e shkruajnë dhe ia shpjegojnë kuptimin në bazë të asaj që e kanë kuptuar nga konteksti. Pastaj i jepet secilit nxënës nga një fletë e ndarë në katër pjesë. Nxënësi duhet të zgjedhë një nga ato fjalët e panjohura që identifikuan më parë në tekst dhe ta shkruajë në njërën pjesë të fletës. Te pjesa tjetër ai shkruan shpjegimin e fjalës së panjohur, në pjesën e tretë shkruan fjalinë ku e përdor fjalën e panjohur, kurse te pjesa e katërt e vizaton (sendin, dukurinë etj.) atë që paraqet fjala e panjohur ose shkruan një ose disa fjalë që ia rikujtojnë fjalën e panjohur.
- Nxënësve të ndarë në grupe të vogla /çifte u jepet një detyrë me situatë të ndryshme komunikimi. Çdo grup/çift simulon sikur ndodhet në



treg, në dyqan, në barnatore, në një klub sporti ose në ndonjë vend tjetër nga përditshmëria e vet dhe nxënësit komunikojnë duke bërë pyetje adekuate për situatën dhe përgjigjen për to. Rolet i ndërrojnë mes vete në mënyrë që secili nxënës të shtrojë pyetje dhe të japë përgjigje.

- Nxënësit ulen në formë rreth dhe secili merr nga një kartelë ku shkruhet ndonjë situatë problemore që mund të hasin në jetën e përditshme. Për shembull: 1. *Topi juaj ra në oborrin fqinj. Fqinji nuk lejon të hyjë kush në oborrin e tij pa e pyetur, ndërsa loja po vazhdon... Çfarë do të bësh?* 2. *Në autobus hyn një gjyshe. Ajo nuk ka vend ku të ulet. Ti je ulur me një çantë të rëndë në shpinë me tesha trajnimi. Çfarë do të bësh?* Shokët e tu të thërrasin të luash, kurse ti s'i ke bërë detyrat e shtëpisë ndonëse ti premtove në shtëpi se më së pari do t'i kryesh detyrat. Çfarë do të bësh? etj. Çdonjëri e lexon situatën "e vet" problemore dhe i përgjigjet pyetjes që ia bëjnë. Nxënësit e tjerë ndjekin dhe japin propozime plotësuese për zgjidhjet e ngjashme a të ndryshme.
- Nxënësit zgjedhin një temë për të cilën shumica e tyre kishin dashur të këmbëjnë përvojën e vet (për vizitë në një ndeshje sportive, pjesëmarrje në një shfaqje të shkollës, një zënkë në oborrin e shkollës etj.). Ata tregojnë me ndihmën e pyetjeve të orientuara: *Çfarë ndodhi në fillim? Më vonë kujt iu drejtuat, çfarë bëtë? Si mbaroi ajo ndodhi? Çfarë mësuat nga një përvojë e tillë?*
- Nxënësit paraqesin gjatë orës detyrat e shtëpisë - një fjalim me disa fjali për një temë të caktuar (P.sh. *Është e shëndetshme të hamë perime. Qeni është shoku më i mirë i njeriut. Libri është burim njohurish.*). Për përgatitjen e fjalimit marrin udhëzime si të përdorin fjali të shkurtra dhe fjali që janë specifike dhe kanë të bëjnë me temën që kanë zgjedhur. Pas çdo fjalimi nxënësit duartrokin.
- Nxënësve të ndarë në çifte u jepen ilustrime dhe një dialog adekuat me ilustrimin që t'i dramatizojnë. Bie fjala, një argëtim ditëlindjeje të një bashkënxënës i tyre, në zyrën e pedagogut, fjalimi para bashkësisë së klasës. Pastaj e diskutojnë se ku dhe si duhet të flasin, me çfarë toni, a duhet t'i drejtohen me ju etj. Çdo çift prezanton dramatizimin e vet, kurse nxënësit e tjerë ndjekin si është përshtatur toni, si shfrytëzohet intonacioni i duhur dhe stili i të folurit nga ana e nxënësve që bëjnë dramatizimin.
- Nxënësit e ndarë në grupe bëjnë kuiz. Grupet marrin një nga një fjalët që duhet t'i ndajnë në rrokje. Çdo përgjigje e saktë shpërblehet me nga një pikë, ndërsa për çdo përgjigje të gabuar ju merret një pikë. Dalin fitimtarë ata që tubojnë më shumë pikë. Në fund, ata diskutojnë se si mund të përcaktohen rrokjet më lehtë.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst me shumë fjali (nga një audio regjistrim ose e lexon mësimdhënësi). Te çdo fjalë ka së paku një fjalë të shqiptuar gabimisht (me theksim të gabuar ose të shqiptuar në gjuhën jostandarde). Nxënësit duhet t'i përcaktojnë fjalët e shqiptuara gabimisht dhe të tregojnë se si duhet të shqiptohen drejt.
- Nxënësve të ndarë në grupe u jepen fjali të shkurtra të shkruara me shenjat përkatëse të pikësimit. Çdonjëri nga grupi lexon nga një fjalë sipas intonacionit të duhur, kurse të tjerët duhet ta gjejnë a është fjalë dëftore, pyetëse ose thirrmore. Në fund bisedojnë se përse është i rëndësishëm intonacioni i duhur për ta kuptuar se çfarë fjalie dëgjojmë (p.sh. nuk ngrihet toni kur shqiptojmë një fjalë dëftore).
- Nxënësit dëgjojnë një rrëfim, kurse pastaj e ritregojnë me gojë sipas një modeli të orientuar: *Na ishte një vajzë e cila jetonte në një vend të largët. Ajo kishte... Për çdo ditë ajo shkonte... Përditë ajo punonte me zell...*

- Mësimdhënësi u jep nxënësve temën për të cilën do të flasin gjatë orës: *“Si mësoj që të di”*. Ata tregojnë se si mësojnë në mënyrë që atë që e mësojnë edhe ta dinë. Gjatë të shprehurit ata përdorin kohën e tashme.
- Mësimdhënësi i motivon nxënësit me anë të pyetjeve të vendosura si rikujtues në tabelë, për të treguar se çfarë kanë bërë ata vetë, po edhe anëtarët e tjerë të familjes kur kanë qenë të sëmurë. Atyre u jepet një shembull që t’i orientojë të tregojnë duke përdorur kohën e pakryer. P.sh. *Kur isha i sëmurë nga fruthi, më kruhej gjithë trupi. Babai më lyente me një pudër të lëngshme me ngjyrë të bardhë.*
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me disa ilustrime që ata duhet t’i plotësojnë deri në fund dhe të rrëfejnë historinë e vet si dëshmitarë të ngjarjes/ngjarjeve. p.sh. Fleta mësimore është e palosur në katër pjesë me ilustrime. Tek e para ka një foto të parkut me fëmijët duke luajtur me top. Në foton e dytë paraqitet vetëm një fëmijë. Në të tretën ka një top. Katrorin e katërt ata e vizatojnë vetë duke bashkuar atë që paraqitet në tri pjesët e para dhe tregojnë se çfarë ka ndodhur më tej.
- Mësimdhënësi u lexon nxënësve një tregim ku personazh kryesor është një fëmijë i moshës së tyre, i cili vepron me guxim dhe ndershmëri në një situatë të caktuar, kurse ngjarjet jepen në mënyrë kronologjike. Nxënësit, duke ndjekur këtë shembull, tregojnë një histori të ngjashme, të përjetuar ose të përfytyruar, në të cilën ata shfaqen si heronj kryesorë dhe ngjarjet i paraqesin sipas radhës së tyre. Kur tregojnë ata përdorin vetën e parë të foljeve në kohën e shkuar (si p.sh. isha, pashë, mora, gjeta, solla...).
- Nxënësit diskutojnë për temën: *Një serial i preferuar për fëmijë ose Një lojë te preferuar on-line*. Nxënësit përdorin fjalë të përshtatshme për temën dhe kujdesen të rrëfejnë në kohën e tashme dhe në kohën e shkuar, si p.sh. *E dua këtë serial, sepse...; Në të ka... personazhe që...; Kur isha i vogël e doja lojën... për arsye se...*
- Nxënësit përshkruajnë mjedisin jetësor pasi kanë bërë vëzhgim në rrethin e afërt. Sipas udhëzimeve të mësimdhënësit ata përdorin sa më shumë përshkrime për sendet konkrete, objektet dhe krijesat që i kanë parë. P.sh. *Rruga jonë është e madhe dhe e ndritshme. Në rrugën tonë ka një varg pemësh të gjelbra. Në rrugë ka edhe shumë automjete, nga dy para secilës shtëpi. Kur bie shumë shi, rruga mbushet me ujë nga njëra anë. Pas rrugës sonë ka edhe një stadium të madh...*
- Nxënësit dëgjojnë një tekst në ligjëratën e drejtë dhe kanë për detyrë ta kthejnë atë në ligjëratën e zhdrejtë. P. sh. - *Mimoza, eja në oborrin tonë të luajmë. – Do të vij menjëherë, Sara, vetëm t’i njoftoj prindërit./ Sara e thërriti Mimosën për të luajtur në oborr e tyre. Mimoza iu përgjigj se do të shkonte, por vetëm sa t’i njoftonte prindërit.*
- Nxënësit punojnë në çifte dhe hartojnë dialogë me nga tri fjali, duke përdorur fjali dëftore, pyetëse, nxitëse, thirrmore, dëshirore, pohore dhe/ose mohore. Ata shkëmbejnë dialogët e vet me një çift tjetër dhe dialogët “e huaj” i kthejnë nga ligjëratat e drejtë në të zhdrejtën.
- Nxënësit punojnë në çifte duke i kthyer nga ligjëratat e zhdrejtë në ligjëratën e drejtë fjalitë e shkruara në fletë mësimore. (*Beni e thirri Gonin dhe i tha se Ardi i priste te qoshku. Beni e thirri Gonin dhe i tha: - Ardi na pret te qoshku.*)

Fusha programore: <b>TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT</b> Gjithsej: <b>65 orë</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit:</b> Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: <ol style="list-style-type: none"> <li>të dallojë fjalën, fjalinë dhe tekstin;</li> <li>të formulojë pyetje dhe t'u përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e një teksti të lexuar, të gjejë informacionet brenda tekstit dhe të bëjë përmbledhjen e tij;</li> <li>të respektojë rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit të një teksti sipas diktimit, nga rikujtimi i një teme të dhënë;</li> <li>të përdorë në formën e duhur emrat, mbiemrat, foljet dhe numërorët në fjali gjatë të shkruarit;</li> <li>të dallojë llojet e ndryshme të fjalive në një tekst.</li> </ol>	
<b>Përmbajtjet (dhe konceptet):</b>	<b>Standardet për vlerësim:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Fjala, fjalia dhe teksti</b></li> <li><b>Fjalia e vogël</b> (kryefjalë e kallëzues)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon fjalën si tërësi tingujsh.</li> <li>Përcakton sa fjalë ka në fjali.</li> <li>Dallon fjalitë në tekst.</li> <li>Dallon tekstin si një tërësi fjalësh.</li> <li>Dallon fjalinë e vogël në tekstin e dhënë.</li> <li>Dallon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalinë e vogël.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Leximi me të kuptuar</b> (teksti letrar dhe teksti joletrar)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon tekstin me intonacionin e duhur.</li> <li>Formulon pyetje lidhur me përmbajtjen e tekstit të lexuar.</li> <li>U përgjigjet (me gojë e me shkrim) pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit të lexuar.</li> <li>Gjen fjalë e fjali si përgjigje të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit të lexuar.</li> <li>Bën përmbledhjen (rezydenë) e përmbajtjes së tekstit që ka lexuar me anë të një a dy fjalive.</li> <li>Dallon tekstet letrare dhe tekstet joletrare.</li> <li>Gjen informacionet që i kërkohen në tekstet joletrare (shkencore-popullarizuese dhe gazetares).</li> <li>Jep përgjigje të thjeshta për pyetjet lidhur me informacionet që paraqiten në ndonjë tekst, tabelë, grafik ose hartë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Shkrimi dhe përdorimi i rregullave të drejtshkrimit</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E përdor drejt shkronjën e parë të madhe kur shkruan emrat e rrugëve, të shesheve, të vendbanimeve, të maleve, të lumenjve, të institucioneve, titujt e librave e të revistave.</li> <li>Shkruan <i>dy pikat</i> dhe <i>presjen</i> në raste numërimi të gjërave.</li> <li>Shkruan tekste të shkurtra sipas diktimit duke iu përmbajtur rregullave drejtshkrimore për përdorimin e shkronjës së parë të madhe dhe të shenjave të pikësimit.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kur shkruan di t'i mbartë si duhet pjesët e fjalëve në rreshtin tjetër.</li> <li>• Shkruan me fjalë numrat deri më 1000 dhe mbiemrat marrëdhëndhënorë që tregojnë sasi deri më 20</li> <li>• Dallon renditjen e parregullt të shkronjave të fjalët e shkruara dhe radhitjen e gabuar të fjalëve në fjalitë e shkruara dhe i rishkruan si duhet fjalët, përkatësisht fjalitë e tilla.</li> <li>• Gjen dhe i përmirëson gabimet në tekstin e shkruar (renditjen e gabuar të shkronjave, lënien e ndonjë shkronje, ndarjen e gabuar të fjalës në fund të rreshtit, përdorimin e gabuar të shenjave të pikësimit).</li> <li>• Shkruan tekste të thjeshta për një temë të përcaktuar ose për një temë të lirë.</li> <li>• Shkruan një tekst të thjeshtë duke rikujtuar ndonjë ngjarje dhe duke iu përmbytur rregullave të drejtshkrimit.</li> <li>• Shkruan tekste të shkurtra për përdorime të ndryshme (kartolinë, mesazh SMS, njoftim).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Llojet e fjalëve në fjali</b> (emrat, mbiemrat, përemrat, foljet, numrorët)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon konkretisht emrat në një tekst të caktuar.</li> <li>• Dallon emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm në një tekst të caktuar.</li> <li>• Dallon emrat për nga gjinia dhe numri.</li> <li>• Dallon mbiemrat në tekstin e dhënë.</li> <li>• Dallon përemrat si fjalë që mund të përdoren në vend të emrave.</li> <li>• Dallon foljen në fjali.</li> <li>• Dallon në tekst numërorët si një lloj fjalësh.</li> <li>• Shkruan tekste duke i përdorur si duhet emrat, mbiemrat, përemrat, foljet dhe numërorët.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Llojet e fjalive</b> (fjalitë dëftore, pohore, mohore, pyetëse dhe thirrmore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon llojin e fjalive në tekstin e caktuar.</li> <li>• Kthen fjalitë që ka lexuar nga një lloj në llojin tjetër.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></li> <li>• <i>Loja me kapakë</i> – Në kapakë shishesh kemi të ngjitur nga një shkronjë. Nxënësit në grupe angazhohen për rreth 5 minuta që nga kapakët me shkronja të formojnë fjalë. Pas 5 minutave aktiviteti ndërpritet dhe nxënësit lexojnë fjalët e formuara.</li> <li>• Nxënësit luajnë lojën me “fjalë” duke tërhequr nga një fletë të vogël nga kutia. Nxënësit tërheqin fletët ku është shënuar një fjalë me shkronjat e ngatërruara. Secili çift mundohet të krijojë fjalë nga shkronjat e shënuara. Pastaj çiftet plotësojnë shkronjat që mungojnë në fjalë dhe në fund i vendosin ato në tabelë dhe i komentojnë.</li> <li>• Nxënësve të ndarë në grupe u jepet nga një zarf me etiketa ngjyrash të ndryshme ku janë shkruar disa fjalë. Nxënësit kanë për detyrë që prej tyre të formojnë fjali. Pasi t'i ndërtojnë fjalitë me kuptim, ata numërojnë sa fjalë ka çdo fjali.</li> <li>• Nxënësit e ndarë në grupe tërheqin nga një zarf me etiketa me fjali. Ata duhet të radhisin fjalitë sipas kuptimit duke formuar një tekst të shkurtër. Tekstin e shkruajnë në fletore dhe përcaktojnë numrin e fjalive në të. Pastaj e prezantojnë para të tjerëve në klasë.</li> <li>• Nxënësve në grupe u shpërndahet nga një tekst (teksti duhet të ketë edhe fjali të vogla prej dy gjymtyrësh ). Nxënësit angazhohen që t'i</li> </ul>	

dallojnë dhe t'i shkruajnë në fletë vetëm fjalitë e vogla. Pastaj çdo grup lexon para nxënësve se cilat fjali të vogla i ka veçuar nga teksti.

- Nxënësve u jepen fleta pune me ilustrime të ndryshme (p.sh. nxënësi duke lexuar një libër, motra duke pastruar dhomën, babai duke punuar në kopsht, fëmijët duke luajtur). Nxënësit angazhohen të punojnë në grupe dhe poshtë çdo ilustrimi të dhënë të formojnë nga një fjali të vogël me kuptim. Në fund, grupet i lexojnë fjalitë e shkruara.
- Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi me teknikën “Stuhi idesh”, mundohen të gjenerojnë shumë kallëzues për të formuar fjali të vogla (p.sh. *Nxënësi – shkruan, lexon, vrapon, këndon, mëson, punon* etj.), të cilat njëkohësisht shënohen edhe në tabelë. Pasi të kuptojnë fjalinë e vogël, atë e dallojnë në fletët e punës ku është paraqitur një tekst i shkurtër me katër ose pesë fjali.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili nxënës nga një kapelë a kuti tërheq nga një etiketë ku është shkruar nga një fjali (fjalitë në etiketa mundësisht të jenë të ndryshme). Nxënësit pasi i lexojnë fjalitë i presin etiketat duke e ndarë kryefjalën dhe kallëzuesin dhe në afishen që është përgatitur më parë nga mësimdhënësi, të ndarë në dy kolona, nxënësit ngjisin kryefjalën dhe kallëzuesin në vendin e duhur. Në fund gjithë nxënësit bëjnë një shëtitje në klasë duke i komentuar se a e kanë vënë në vendin e duhur kryefjalën dhe kallëzuesin.
- Nxënësit lexojnë tekste të shkurtra para të gjithë nxënësve në klasë duke zhvilluar lojën e folësit në TV duke përdorur intonacionin e duhur dhe duke iu përmbajtur shenjave të pikësimit dhe llojit të tekstit.
- Nxënësve u jepet një tekst i shkurtër. Pasi ta lexojnë tekstin, atyre u jepet detyrë të shkruajnë disa pyetje rreth përmbajtjes së tekstit që lexuan (kush, çfarë, ku, kur, si, pse). Në fund pyetjet lexohen dhe shkruhen në tabelë.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst të incizuar me zë (audio), pastaj të ndarë në çifte u përgjigjen pyetjeve të parashtruara në fletat e punës (*Cila ngjarje është paraqitur në tekst? Kush merr pjesë në ngjarje? Kur ka ndodhur ngjarja dhe ku?*).
- Nxënësit në mënyrë të pavarur lexojnë tekst me 8-10 fjali. Më pas, duke e shfrytëzuar teknikën *insert*, e gjejnë përgjigjen e tri pyetjeve që janë poshtë tekstit (pyetjet udhëzojnë në gjetjen e fjalisë dhe fjalëve kyçe të tekstit).
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër (me 8 deri 10 fjali) me temë *Koha e lirë*, e pastaj shkruajnë përfundimin e tekstit sipas tyre me një a dy fjali.
- Nxënësve u jepet nga një fletë ku janë të shtypura disa tekste (të shkurtra) letrare dhe joletrare. Nxënësit në çifte lexojnë tekstet dhe anash në tekst shënojnë se a është teksti letrar a joletrar.
- Nxënësve u jepen dy kartela me ngjyra të ndryshme (kartela me ngjyrë të gjelbër të ngrihet kur nxënësit mendojnë se teksti është letrar, ndërsa kartela e kuqe të ngrihet kur nxënësit mendojnë se teksti është joletrar). Mësimdhënësi lexon me zë tekstin dhe pas çdo leximi i pyet nxënësit se cilit lloj të tekstit i takon. Nxënësit me ngritjen e kartelave tregojnë se çfarë ishte teksti i lexuar. Në fund mësimdhënësi tregon se cilat ishin tekste letrare dhe cilat joletrare. Komentohej sa ia kishin qëlluar nxënësit në dallimin e teksteve.
- Nxënësit lexojnë një tekst shkencor-popullarizues. Në tabelë ose gjatë prezantimit mësimdhënësi paraqet pjesë të tekstit për të cilat u bën pyetje konkrete nxënësve. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve, por argumentin e kërkojnë në pjesët e nxjerra nga teksti me të cilat i orienton mësimdhënësi. Diskutojnë dhe bëjnë rezymenë së bashku duke nxjerrë informacionin kryesor.
- Nxënësit lexojnë një tekst në të cilin ka hartë të një vendbanimi. Poshtë tekstit ka pyetje: *Sa stacione autobusi ju nevojiten për të shkuar nga*

vendi A në vendin B? Çfarë objektesh duhet të kalojnë? A ka ndonjë mënyrë tjetër për të shkuar nga vendi A në vendin B? Të përshkruhet ajo rrugë!.

- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me vizatim/hartë në të cilën paraqitet vendi i tyre me gjërat më të rëndësishme: mali, lumi, rrugët, shkolla e tyre, sheshi, institucionet, por emrat e tyre nuk janë të shënuar saktë. Nxënësit i shkruajnë saktë emrat dhe saktësia kontrollohet para të gjithëve në klasë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me shumë pyetje në të cilat kërkohet të numrojnë shumë gjëra, si, p.sh., *Çfarë i duhet një bime për t'u rritur? Çfarë përmban kompleti i shkollës? Cilat janë frutat më të njohura që rriten në vendin tonë?* Nxënësit udhëzohen që të kenë kujdes si t'i shkruajnë gjërat kur numërohen. Disa shembuj të përgjigjeve shkruhen në tabelë për t'u vërtetuar nëse janë të sakta.
- Nxënësit shkruajnë një tekst të diktuar me fjali të ndryshme për nga përmbajtja dhe me emërtime që shkruhen me shkronjë të madhe (shkolla, sheshe, rrugë, muzeje, emra personalë). Fjalitë duhet të shkruhen me shenjat e duhura të pikësimit. Pasi mbaron diktimi, mësimdhënësi ua paraqet shembullin e saktë në tabelë dhe nxënësit bëjnë vetëvlerësimin e tyre.
- Nxënësve u shpërndahet një fletë mësimore me një tekst ku janë shkruar shumë fjalë me pjesë të bartura në rreshtin tjetër. Fjalët që janë bartur si duhet në rreshtin tjetër shënohen me shenjën e saktë(✓), kurse ato të pasktat i korrigjojnë poshtë tekstit. Së bashku kontrollohen në tabelë.
- Nxënësve u jepet një tekst me të dhëna që shprehen me numra (për shembull, lartësitë e ndërtesave që njihen në botë përgjithësisht si monumente). Të gjitha numrat i shkruajnë me fjalë, pastaj i rendisin me numër rendor: *e para është e lartë..., e dyta është e lartë...* Kontrollohen së bashku nëse i kanë shkruar saktë.
- Nxënësve të ndarë në grupe u jepet nga një fletë pune, në të cilën ka një tekst ku radhitja e fjalëve në fjali nuk është e saktë, por edhe radhitje të gabuar të shkronjave brenda fjalës, si p.sh.: *veshtra-vreshta, protokall-portokall, lejleku-leljeku, meca- mace*. Nxënësit i shkruajnë fjalët sipas radhitjes së duhur dhe e prezantojnë tekstin e shkruar.
- Nxënësit punojnë në çifte, secilit i jepet nga një tekst me gabime drejtshkrimore siç është mosshkrimi i shenjave të pikësimit dhe bartja gabim e pjesës së fjalës në rreshtin tjetër. I korrigjojnë gabimet dhe pastaj i shkëmbejnë fletëzat e tyre me tekstin e shkruar për t'u vërtetuar se me çfarë përpikërie e kanë kryer lekturën.
- Nxënësve u jepet detyrë të shkruajnë një tekst të shkurtër prej 5-6 fjalish që do t'i referohej ndonjë tregimi a libri me ilustrime më të bukur që kanë lexuar. Mësimdhënësi ka vendosur në tabelë këto pyetje për nxënësit: *Cili është tregimi /libri juaj më i dashur me ilustrime?; Pse e ke zgjidhur si tregimin / librin tënd më të dashur me ilustrime?; A ka ndonjë personazh veçmas interesant që e bën atë tregim / libër me ilustrime të jetë i rëndësishëm për ty?* Në mënyrë të veçantë mësimdhënësi e thekson të kenë kujdes si i shkruajnë shenjat e pikësimit. Atë që kanë shkruar e këmbëjnë me nxënësit e tjerë në klasë.
- Nxënësit bëjnë një krijim rreth temës që është shkruar në tabelë, por që ndërlihet me një ngjarje të zhvilluar në shkollë (aksion humanitar, garë sportive, shfaqje teatrale, festë e patronatit etj.). Përveç udhëzimit për ta hartuar me kujdes përmbajtjen, nxënësit udhëzohen që t'u përmbahen rregullave të drejtshkrimit. Krijimet i këmbëjnë në çifte dhe i kontrollojnë.
- Nxënësit ndahen në grupe: njëri grup merr për detyrë të shkruajë një kartolinë për Vitin e Ri, grupit tjetër i jepet detyrë të shkruajë një

kartolinë për ditëlindje, kurse grupit tjetër i thuhet të shkruajë një porosi SMS. Të gjitha punimet i lexojnë grupet dhe paraqiten para klasës, kurse mësimdhënësi komenton përmbajtjen e tyre dhe jep njoftim prapaveprues (feed-back) se sa i kanë përfillur rregullat e drejtshkrimit.

- Nxënësve u jepet një tekst ku mungojnë emrat, ata e lexojnë gjithë tekstin dhe i plotësojnë vendet boshe. Pastaj ata i lexojnë fjalët që shkruan dhe komentojnë se ç'kuptim ka fjala: është term gjeografik, emër personal, emër bime, kafshe, objekti, sendi etj. Së bashku me mësimdhënësin ata nxjerrin përfundimin se fjalët që përdoren për të emërtuar sende, kafshë ose njerëz quhen emra.
- Nxënësve u jepet nga një fletëz mësimore plot me emra dhe kanë për detyrë t'i ngjyrosin me të verdhë emrat e njerëzve/emrat e përveçëm dhe me të gjelbër emrat e tjerë që janë emra frymorësh e sendesh. Kontrollonjë së bashku në tabelë duke shënuar shembujt e saktë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune në të cilën tregohen ilustrime të objekteve dhe krijesave. Në një ilustrim paraqitet një objekt/krijesë, kurse në tjetrin më shumë. Nxënësit shkruajnë emrat nën ilustrimet dhe diskutojnë për dallimet e tyre, emrat mund të jenë të ndryshëm dhe të jenë të gjinisë mashkullore dhe femërore, në njëjës dhe në shumës.
- Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa emra (p.sh. *lapsi, zogu, fletorja, të menduarit, të kënduarit, hëna, dielli, libri, Emira, lulja, të shkruarit*). Nxënësit, të ndarë në çifte, angazhohen që t'i ndajnë në tri kolona: emrat që janë të gjinisë femërore, emrat që i takojnë gjinisë mashkullore dhe emrat e gjinisë asnjësore. Në fund prezantojnë dhe lexojnë emrat e ndarë në tri kolona.
- Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa emra, ndërsa nxënësit angazhohen që t'i ndajnë në dy bashkësi (njëjës, shumës) emrat e shkruar në tabelë. Pasi ta kryejnë detyrën e dhënë, nxënësit lexojnë se cilët emra i kanë përfshirë në numrin njëjës dhe cilët në numrin shumës.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe punojnë veprimtarinë (aktivitetin) *Zbukuroni tekstin* (duke shtuar mbiemra). Teksti që u jepet pas emrit ka një hapësirë boshe për ta plotësuar. Secili grup prezanton punimin e vet.
- Nxënësve u ndahet nga një fletë ku janë shkruar nga tri fjali. (p.sh. (Arba) është valltare. (Sokoli) luan në piano. (Djemtë) pikturojnë. (Vajzat) kanë kukulla). Nxënësve u jepet detyrë që emrat në kllapa t'i zëvendësojnë me përemra. Në fund lexojnë dhe diskutojnë se me cilët përemra i kanë zëvendësuar emrat.
- Nxënësve u shpërndahen fletë me një tregim të shtypur (ku përveç emrave duhet të ketë edhe përemra). Nxënësit në çifte marrin detyrë që në tekstin e dhënë t'i nënvizojnë përemrat me ngjyrë të kuqe. Në fund, çdo çift lexon se cilët përemra i ka nënvizuar dhe diskutohet se a i kanë nënvizuar saktë.
- Nxënësve u shpërndahen ilustrime dhe u jepet detyrë të shkruajnë se kush çfarë bën / çfarë ndodh në ilustrim. Përderisa i shkruajnë shembujt, ata duhet të kenë parasysh vetën dhe kohën me të cilat shprehet veprimi i foljes.
- Nxënësve u jepet nga një fletëz pune me dy tekste të shkurtra. Në tekstin e parë kanë për detyrë të nënvizojnë numërorët. Në të dytin kanë për detyrë ta plotësojnë tekstin me numërorët e duhur.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me fjali që nuk kanë shenja pikësimi në fund. Ata i lexojnë fjalitë, vendosin shenjën përkatëse të pikësimit dhe i përcaktojnë fjalitë sipas llojit (dëftore, pohore, mohore, pyetëse dhe thirrmore).
- Secili nxënës duhet ta vizatojë kafshën e tij të preferuar. Pasi të mbarojnë, nxënësit qëndrojnë në një rreth dhe kanë një top të vogël. Pas sinjalit të mësimdhënësit, nxënësi i parë me tophin në dorë e thotë një fjali dëftore për kafshën e tij të preferuar dhe ia kalon tophin

<p>nxënësit tjetër. Nxënësi tjetër së pari e kthen fjalinë dëftore në fjali pyetëse, kurse pastaj thotë një fjali të re dëftore dhe ia jep topthin nxënësit të tretë. Kjo procedurë përsëritet derisa të gjithë nxënësit të thonë së paku nga një fjali.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësve të ndarë në çifte mësimdhënësi u jep nga pesë ilustrime. Çdonjëri nga nxënësit në çift shkruan në mënyrë të pavarur nga një fjali pohore për çdo ilustrim. Pastaj i këmbëjnë me shokun/shoqen fjalitë e shkruara pohore që t'i shndërrojnë ato në fjali mohore dhe t'i shkruajnë.</li> </ul>	
<p>Fusha programore: <b>LETËRSIA, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA</b> Gjithsej: <b>60 orë</b></p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit:</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>të dallojë tekstin e dramës, të poezisë dhe tekstin narrativ (tregim, kallëzim, përrallë, përrallëz) dhe t'i sqarojë dallimet midis tyre me anë të shembujve;</li> <li>të analizojë përmbajtjen e një teksti letrar (temën, porosinë/idenë, personazhet dhe ngjarjet);</li> <li>të ritregojë tekste letrare me fjalët e veta sipas planit të dhënë ose sipas planit të vet;</li> <li>të tregojë (me gojë e me shkrim) rreth një teme të caktuar dhe një teme me zgjedhje.</li> </ol> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>të zhvillojë të shprehurit krijues.</li> </ol>	
<b>Përmbajtjet (dhe konceptet):</b>	<b>Standardet për vlerësim:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Llojet e teksteve letrare</b> (tregim, përrallë, përrallëz, vjershë, dramë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpjegon (nëpërmjet shembullit) dallimin midis një tregimi të shkurtër, një përralle dhe një përrallëze.</li> <li>Bën dallimin ndërmjet tekstit dramatik, poetik dhe narrativ dhe këtë dallim e shpjegon me shembuj.</li> <li>Shpjegon (me anë shembujsh) karakteristikat e poezisë (vargun, strofën, rimën).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Analiza e teksteve letrare</b> (temë, porosi/ide, ngjarje, personazh, kohë, vend)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcakton titullin, emrin e autorit të një libri të caktuar ose të një teksti letrar të caktuar.</li> <li>Përcakton temën e një teksti letrar që ka lexuar.</li> <li>Përcakton personazhet e një teksti letrar të lexuar.</li> <li>Përshkruan pamjen e personazheve të një teksti dhe shpjegon tiparet e tyre sipas veprimeve që bëjnë.</li> <li>Përcakton ngjarjen kryesore në tekst.</li> <li>Përcakton kohën dhe vendin e ngjarjeve në tekst dhe i rendit ato në mënyrë kronologjike.</li> <li>Krahason ngjarjet dhe personazhet nga teksti i lexuar me situatat reale.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxjerr porosinë e përmbajtjes së një teksti letrar të lexuar.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të shprehurit me gojë e me shkrim dhe të krijuarit</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregon një tekst letrar sipas një plani të dhënë ose sipas planit të vet, duke përdorur fjalët e veta.</li> <li>• Tregon ngjarje nga jeta e përditshme që kanë ngjashmëri me ato në tekstin letrar.</li> <li>• Rrëfen rreth një teme të përcaktuar ose për temën që e ka zgjedhur vetë.</li> <li>• Krijon një tekst të ri duke ndryshuar pjesë të caktuara të një teksti letrar që ka lexuar.</li> <li>• Tregon sipas një serie fotografish ose ilustrimesh.</li> <li>• Krijon vargje me ose pa rimë për tema të ndryshme.</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit ndahen në grupe. Ata marrin fletë pune me kombinime të dy teksteve: një përrallë e shkurtër dhe një përrallëz (fabul), një përrallëz dhe një tregim të shkurtër, një tregim të shkurtër dhe një përrallë. Në secilin grup lexohen tekstet dhe jepen përgjigje në pyetjet që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe personazhet në tekste: a janë ngjarjet reale, a janë personazhet reale, çfarë vetish kanë personazhet, ku zhvillohet ngjarja. (Nxënësit duke diskutuar nxjerrin përfundimin se në përrallëza personazhet janë kafshë dhe veprimet e tyre janë imitime të të metave të njeriut, përrallat janë tekste që kanë personazhe e objekte (të imagjinuara) fantastike dhe zhvillohen në vende të panjohura dhe të fshehta, tregimet e shkurtra tregojnë për një ngjarje/personazh.</li> <li>• Nxënësit organizohen në grupe ashtu që njëri grup merr një vjershë dhe pastaj e reciton, grupi i dytë merr një tregim të shkurtër, kurse grupi i tretë merr një tekst njëaktësh të cilin e dramatizon/e lexon në mënyrë shprehëse. Detyrat e grupeve këmbehen, kurse në fund mësimdhënësi nxit diskutime rreth ndryshimeve që shfaqen te shembujt që i kanë lexuar dhe nxjerr përfundimet se (teksti i dramës organizohet me anë të vetave/personazheve që zhvillojnë dialog, te teksti rrëfimtar (narrativ) tregohet për ndonjë ngjarje, ku personazhet nuk janë të ndara si te njëaktëshja, teksti i vjershës është shkruar në rreshta të shkurtër – vargje).</li> <li>• Nxënësit në çift lexojnë një vjershë dhe përcaktojnë strukturën e saj me anë pyetjesh orientuese në fletën e punës: <i>Sa pjesë të ndara ka te vjersha? A kanë numër të njëjtë rreshtash të gjitha pjesët e vjershës? A ka te rreshtat çifte fjalësh që mbarojnë me rrokje të njëjta a të ngjashme? Ku ndodhen ato? A mbahen mend këto më lehtë?</i> Nxënësit duhet të dinë t'i shpjegojnë disa koncepte: rreshtat në vjershë janë vargje, të cilat mund të kenë ose të mos kenë rimë; disa vargje formojnë një strofë.</li> <li>• Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr libra, libra me ilustrime, përmbledhje me tregime të shkurtra. Secili grup përcakton titullin, autorin, fjalorin (nëse ka), përmbajtjen e librit që kanë marrë. Grupet prezantojnë duke demonstruar atë që kanë marrë për detyrë.</li> <li>• Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur një tekst rrëfimtar dhe më pas u përgjigjen pyetjeve me plotësim dhe me rrethim të përgjigjeve të dhëna në lidhje me përmbajtjen e tekstit: <i>Për çfarë flitet në tekst?</i> (me përgjigjen e ofruar: për shoqërimin, për arritjen e dimrit, për dëshirën më të madhe që ka një fëmijë ...); <i>Kush merr pjesë në ngjarje?</i> dhe <i>Cilat personazhe janë bartëse të ngjarjeve?</i> Pastaj secili e shkruan vetë temën e tekstit me një fjali dhe ua tregon të tjerëve në klasë.</li> <li>• Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur një tregim me disa personazhe. Pastaj mësimdhënësi ua jep fletët e punës ku parashtrohen pyetje, të</li> </ul>	

radhitura në një rreth të ndarë në katër pjesë të barabarta. Rendi i përgjigjeve për pyetjet sillet në drejtimin e akrepave të orës: *Numëroni personazhet në tekst? Gjej vetinë kryesore që ka secili personazh? Cili personazh të ka lënë më shumë përshtypje dhe pse? Përshkruaj të gjitha vetitë e atij personazhi duke përdorur 1-2 fjali.*

- Nxënësit lexojnë një tekst ku përshkruhet pamja e personazheve, për to do të diskutojnë edhe sa u përket sjelljeve të tyre gjatë ngjarjes dhe veprimeve që bëjnë në tekst. Për diskutimin e hapur shfrytëzohen pyetjet e përgatitura prej më parë (*Me cilat fjalë bëhet përshkrimi i personazhit? Çfarë bëri personazhi në fillim të tekstit? Çfarë bëri personazhi pak më vonë? Ç'mendon lidhur me këtë gjë? Cili veprim të pëlqeu? A mund të kishte vepruar ndryshe ky personazh? ...*)
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur një tekst dhe kanë për detyrë të përcaktojnë ngjarjen kryesore dhe personazhin kryesor në tekst. Mësuesi hap një diskutim dhe nxënësit arsyetojnë përgjigjet e veta – se pse ata e konsiderojnë atë ngjarje kryesore dhe atë personazh kryesor.
- Nxënësit punojnë në fletë pune. Në pjesën e sipërme është teksti në prozë që duhet ta lexojnë, kurse në pjesën e poshtme të fletës së punës ata shkruajnë: kohën dhe vendin e ngjarjeve, ndërsa në gjysmëdrejtëzën e dhënë i shënojnë ngjarjet sipas renditjes kronologjike (shkruajnë nga e majta në të djathtë).
- Nxënësit ndahen në grupe, secili grup merr shirita ku përshkruhen pjesët e një përralle ose një tregimi, ngjarjet e së cilës duhet t'i radhisin në mënyrë kronologjike ashtu që përralla/tregimi të ketë radhitje të përshtatshme ngjarjesh. Secili grup e prezanton punën e tij para klasës. (Nëse një grup kundërshton, zhvillohet diskutim dhe grupi shpjegon pse mendojnë ndryshe).
- Nxënësit në mënyrë të pavarur lexojnë një tekst dhe pastaj njëri prej tyre e lexon tekstin me zë të lartë para të gjithëve. Mësimdhënësi hap diskutim nëpërmjet lojës *“Kam qenë edhe unë në ato këpucë”* ku nxënësit tregojnë një situatë të ngjashme që kanë përjetuar (ose në cilësinë e dëshmitarit).
- Nxënësit lexojnë një tekst në mënyrë të pavarur. Pastaj në fletën mësimore i plotësojnë thëniet: *Ky tekst më shtyri të mendoj për...; Te ky tekst më befasoi ...; Nga ky tekst mësova se...; Andaj mendoj se mesazhi i këtij teksti është...* Fjalitë e shkruara ata i këmbëjnë me nxënësit e tjerë të klasës.
- Nxënësit dëgjojnë një rrëfim audio. Përderisa dëgjojnë ata i shënojnë ngjarjet që ndodhin në formë rikujtuesi. Pastaj duke shfrytëzuar këtë *“rikujtues”*, ata e tregojnë rrëfimin me fjalët e veta.
- Nxënësit lexojnë një tekst që flet për një temë shkollore dhe tregojnë një përvojë të tyre të ngjashme. Teksti i lexuar i ndihmon ata të shkruajnë planin e tyre që do ta ndjekin gjatë të shkruarit.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një temë për krijimtari dhe tërheq një numër nga 1 deri në 4 ose 5, sa anëtarë ka grupi. Nxënësit diskutojnë rreth temës dhe pastaj, duke u ndërlidhur me njëri-tjetrin, trillojnë dhe shkruajnë nga një fjali për të krijuar një tërësi të kuptimshme që mund të jetë edhe komike. I pari fillon nxënësi që ka tërhequr numrin 1. Puna që është bërë u prezantohet të gjithëve.
- Mësimdhënësi e lexon një tekst ku paraqiten pasojat e ndonjë ngjarjeje. Nxënësit e shkruajnë me disa fjali fillimin e tregimit.

<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësi paraqet në tabelën e mençur një fotografi ose disa të tilla (mund të përdoren edhe postera, kalendarë etj.) të një peizazi nga mjedisi ku jetojnë nxënësit. Duke vënë re detaje nga fotografi-a/-të, nxënësit krijojnë dhe më vonë atë që kanë krijuar e shkëmbejnë me të tjerët.</li> <li>Nxënësit krijojnë vargje për një temë që ka të bëjë me një ngjarje ose me një person nga mjedisi i tyre që u ka lënë mbresa. Secili nxënës vizaton një rreth idesh në fletoren e tij në të cilin shënojnë së paku dhjetë fjalë në lidhje me atë që duan të shkruajnë dhe më pas i organizojnë ato në vargje. Mësimdhënësi u jep udhëzime se është e rëndësishme që vargjet të kenë kuptim dhe jo gjithmonë duhet të rimojnë. Ajo që shkruhet prezantohet para të gjithëve.</li> </ul>	
<p>Fusha programore: <b>NJOHURI MEDIATIKE DHE KULTURË E MEDIAS</b>  Gjithsej: <b>15 orë</b></p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit:</b>  Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>të paraqesë shembuj për të shpjeguar/përshkruar se si ndikon media te përdoruesit;</li> <li>të shpjegojë se si përdoret në mënyrë të sigurt telefoni celular për të pasur qasje te informacionet nëpërmjet aplikacioneve;</li> <li>të kërkojë dhe të gjejë informacionet e nevojshme në internet duke përdorur fjalët kyçe;</li> <li>të krijojë përmbajtje të thjeshta mediatike duke lidhur tekstin me ilustrimet.</li> </ol>	
<p><b>Përmbajtjet (dhe konceptet):</b></p>	<p><b>Standardet për vlerësim:</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ndikimi i medimeve</b> (informacione problematike dhe edukuese, përmbajtje manipuluese)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën dallimin ndërmjet informacionit problematik dhe atij edukues në përmbajtjen mediatike.</li> <li>Shpjegon (me shembuj) se si ndikojnë përmbajtjet nga mediet në emocionet e atyre që i shfrytëzojnë.</li> <li>Identifikon përmbajtjet manipuluese në media.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Përdorimi i telefonit celular</b> (pajisje e mençur, aplikacione për telefon/pajisje të mençur, ikona, emotikone)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Paraqet aplikacione të telefonit celular/pajisjes së mençur të cilat janë të dobishme dhe të sigurta për t'u përdorur.</li> <li>Shpjegon (me shembull) dallimin ndërmjet përdorimit të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm të telefonit celular.</li> <li>Shpjegon (me shembull) pse fjalëkalimin e telefonit nuk duhet ta dinë të tjerët.</li> <li>Shpjegon (me shembull) dallimin ndërmjet komunikimit të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm nëpërmjet telefonit celular (nëpërmjet bisedës ose mesazheve).</li> <li>Ilustron një mesazh tekstual me një emotikon të përshtatshëm</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kërkimi në internet</b> (vegëzë/link, fjalë kyçe, Google)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon (me shembull) çfarë paraqet interneti.</li> <li>• Përcakton fjalët kyçe në fjali dhe në tekste të shkurtra.</li> <li>• Gjen informacionin e nevojshëm në internet duke kërkuar në Google.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Krijimi i përmbajtjeve të thjeshta mediatike</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mënyra të ndryshme për të paraqitur informacione (tekst, imazh/fotografi, regjistrime në video).</li> <li>• Krijon përmbajtje mediatike për një temë të caktuar, të përbërë nga teksti dhe imazhi, nga fotografia ose nga regjistrimi në video.</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësimdhënësi bën zgjedhjen e disa përmbajtjeve mediatike (fragmente nga filmat vizatimorë, video-lojëra etj.) ku paraqiten situata problematike (dhunë, fyerje, gënjeshtër, stereotipa, diskriminim, poshtërime, maltretime etj.) dhe/ose që kanë karakter edukues (që nxisin shoqërimin, mirëkuptimin, ndihmën ose që mundësojnë të mësohet diçka e dobishme). Pas shfaqjes së secilës përmbajtje mediatike (e cila mund të përfshijë përmbajtje edhe edukuese edhe problematike) kërkohet nga nxënësit të tregojnë kartonin e gjelbër nëse përmbajtja është këshilluese ose kartonin e kuq nëse përmbajtja është problematike dhe të shpjegojnë pse mendojnë ashtu. Pasi paraqiten të gjitha përmbajtjet mediatike bëhet një përmbledhje e shkurtër se kur informacionet e dhëna konsiderohen problematike e kur edukuese. Në fund diskutohet se cilat do të ishin pasojat nëse këto situata mund të ndodhnin në realitet.</li> <li>• Mësimdhënësi paraqet disa video incizime me emocione të shprehura (p.sh. një fëmijë që qan se i ka humbur qeni; një fëmijë që ka humbur në pyll; një fëmijë që i fryn qirinjtë e ditëlindjes; një fëmijë që përqafohet me prindërit e tij) dhe pas çdo incizimi kërkohet që nxënësit të thonë se cili emocion shfaqet aty. Më pas nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup tërheq një letër ku është shkruar një emocion (p.sh. lumturi, gëzim, pikëllim, frikë, dashuri). Detyra e tyre është të vënë në dukje përmbajtjen mediatike (film vizatimor, film artistik, serial për fëmijë, këngë, videoklip) që shkakton një emocion të tillë tek ata. Pasi t'i ndajnë të gjitha grupet përvojat e tyre, nëpërmjet një diskutimi të hapur nxirret përfundimi se shumica e përmbajtjeve mediatike janë krijuar për të ngjallur emocione të shfrytëzuesit e tyre.</li> <li>• Mësimdhënësi vizaton dy fytyra në tabelë – njëra e vrenjtur dhe tjetra e gëzuar. Nxënësit ndahen në katër grupe. Dy grupe marrin një fletë me tekstin e mëposhtëm:  <i>“Në një planet jetonin Bancët dhe Doncët. Bancët ishin të zgjuar, punëtorë, mikpritës dhe gjithmonë me humor të mirë. Për dallim nga ata, Doncët ishin dembelë, ziliqarë, agresivë dhe gjithmonë të vrenjtur.”</i>  Dy grupet e tjera marrin tekstin e mëposhtëm:  <i>“Në një planet jetonin Doncët dhe Bancët. Doncët ishin të zgjuar, punëtorë, mikpritës dhe gjithmonë me humor të mirë. Për dallim nga ata, Bancët ishin dembelë, ziliqarë, agresivë dhe gjithmonë të vrenjtur.”</i>  Çdo grup bie dakord brenda vetes se cili vizatim në tabelë përfaqëson Bancët dhe cili përfaqëson Doncët. Më pas, mësuesi pyet se cilin person</li> </ul>	

e kanë identifikuar më njërin vizatim, a cilin me tjetrin. Pasi të konstatohet se zgjedhja është e ndryshme për grupe të ndryshme, grupet lexojnë tekstin që kanë marrë dhe konstatojnë dallimet. Hapet një diskutim për pyetjet vijuese: (1) *Ai që ka shkruar tekstin për Bancët e gëzuar dhe Doncët e vrenjtur, është Banc ose Donc? Kush e shkroi tekstin tjetër?* (2) *Si i përjetuat Bancët dhe si Doncët? Nga çka varej përjetimi juaj?* (3) *Çfarë do të ndodhte nëse incizohet një film i frymëzuar nga një version, pa u ditur versioni tjetër? Cilët do të jenë më simpatikë për shikuesit (Doncët apo Bancët)?* Në fund mësimdhënësi paraqet shembuj të reklamave për disa produkte (p.sh. pajisje që pastron gjithçka, pastën më të mirë për pastrimin e dhëmbëve, vitamina që japin forcë). Duke diskutuar arrihet në përfundimin se përmbajtjet mediatike shpesh krijohen për të nxjerrë në pah vetëm disa gjëra ose për t'i shtrembëruar gjërat në dobi të dikujt.

- Fillohet me një diskutim të hapur me pyetjet: *Pse telefonat celularë quhen telefona të mençur?* (Përgjigjja e pritshme: Sepse jo vetëm që mundësojnë të zhvillohen biseda telefonike, por mund të transmetojnë edhe informacione). *Cilat pajisje të tjera janë të mençura?* (Përgjigjja e pritshme: Tableti). Pastaj nxënësit ndahen në grupe me detyrë që të gjejnë aplikacione të telefonave celularë (ata që janë pjesë e telefonave - nuk kanë nevojë të instalohen sërish) nëpërmjet të cilëve mund të lexojnë sa është ora, të bisedojnë me telefon, të dërgojnë dhe të marrin mesazhe, të fotografojnë, të incizojnë e të ruajnë fotografitë/incizimet e realizuara, të shfrytëzojnë kalendarin, të ndjekin aktivitetin e vet, të dëgjojnë muzikë e të shikojnë video-incizime dhe të luajnë video-lojëra. Grupet (në mënyrë alternative) i vizatojnë në tabelë ikonat për secilin aplikacion të gjithë llojeve të telefonave celularë që gjenden në klasë. Në fund, me një diskutim të hapur konstatohet se: (1) aplikacionet e përfshira janë të sigurta për t'u përdorur sepse janë pjesë e telefonave dhe (2) shumica e aplikacioneve që janë në telefonat e mençur mund të gjenden edhe në tablete, të përfaqësuara nga ikona të njëjta ose të ngjashme.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin fletë pune me situata të përdorimit të zakonshëm të telefonit celular, me detyrë që nëpërmjet diskutimit në grup të identifikojnë se cilat përskrime tregojnë përdorim të përgjegjshëm e cilat përdorim të papërgjegjshëm të telefonave. Përskrimet e mëposhtme mund të shërbejnë si shembuj:
  - (1) Gjatë kohës së drekës, Filipi lexon dhe shkruan mesazhe në telefonin e vet celular. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm/ joadekuat).
  - (2) Derisa mëson, Enisi e mban celularin jashtë fushës së shikimit. (Përgjigjja e duhur: I përgjegjshëm/adekuat).
  - (3) Sanela e përdor celularin e saj për të gjetur informacione që i nevojiten për të shkruar detyrat e shtëpisë. (Përgjigjja e duhur: I përgjegjshëm/adekuat).
  - (4) Maja e përdor telefonin e saj celular çdo ditë nga tri orë ose edhe më shumë për të luajtur video-lojëra. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm/ joadekuat).
  - (5) Agoni fshehurazi lexon dhe shkruan mesazhe në celularin e tij gjatë orës së mësimet. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm/ joadekuat).Për çdo përskrim (njëri pas tjetrit) grupet tregojnë përgjigjet e tyre dhe japin arsyt pse janë përgjigjur në atë mënyrë, ndërsa mësimdhënësi i orienton drejt argumenteve që çojnë në përgjigjet e duhura. Gjatë një diskutimi të hapur, nxirret përfundimi se kur merremi gjatë kohë me telefonin celular, kjo na pengon t'i kryejmë në kohë detyrat e tjera dhe ka për pasojë formimin e shprehive jo të mira (duke zënë shpesh vendin e aktivitetit fizik dhe të shoqërimeve të mirëfillta).

- Nxënësve u paraqitet një situatë në të cilën celulari i dikujt tjetër po keqpërdoret për t'u dërguar të tjerëve mesazhe të papërshtatshme (p.sh.: Shokët i kërkuan një fëmijë t'ua tregonte fjalëkalimin e telefonit celular. Në fillim fëmija nuk ka dashur t'ua tregojë, por pasi i kanë premtuar se nuk do ta keqpërdorin, ai është pajtuar. Më pas ia kanë marrë fshehurazi telefonin dhe e kanë përdorur për t'u dërguar mesazhe të papërshtatshme fëmijëve të tjerë). Nxënësit, të ndarë në grupe, u përgjigjen pyetjeve: *Pse fëmija ua dha fjalëkalimin? Për çfarë u përdor fjalëkalimi? Si e dëmtoi fëmijën ky veprim? Si mund të përdoret ndryshe telefoni për të dëmtuar fëmijën?* Pasi të shpërndahen përgjigjet para të gjithëve, nëpërmjet një diskutimi të përbashkët nxirret përfundimi se zbulimi i fjalëkalimit personal cenon të drejtën për privatësi të fëmijës dhe mundëson keqpërdorimin e telefonit për të dëmtuar vetë fëmijën.
- Nxënësve të ndarë në grupe u jepen fletë pune me shembuj të përshkrimeve të komunikimit nëpërmjet mesazheve në telefonin celular, me detyrë që nëpërmjet diskutimit në grupe të identifikojnë se cilat përshkrime tregojnë komunikim të përgjegjshëm e cilat komunikim të papërgjegjshëm. Përshkrimet e mëposhtme mund të shërbejnë si shembuj:
  - (1) Ana shkruan komente fyese për të tjerët kur mendon se ata e meritojnë. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm)
  - (2) Anita nuk u jep të tjerëve informacione të besueshme nëpërmjet mesazheve. (Përgjigjja e duhur: I përgjegjshëm)
  - (3) Aleksi nuk e quan veten fajtor që i dërgoi Mirit një mesazh fyjes për Ilirin. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm)
  - (4) Arta mendon se mund të shkruajë çfarë të dojë për dikë tjetër nëse nuk e përmend emrin e tij/e saj në mesazh. (Përgjigjja e duhur: I papërgjegjshëm)
  - (5) Agimi nuk shkruan gjëra fyese për të tjerët edhe atëherë kur dëshiron të bëjë shaka me ta. (Përgjigjja e duhur: I përgjegjshëm)
  - (6) Hatixhja nuk shkruan në mesazhe asgjë që nuk është e përshtatshme për t'i thënë dikujt sy për sy. (Përgjigjja e duhur: I përgjegjshëm)
 Për çdo përshkrim (njëri pas tjetrit) grupet paraqesin përgjigjet e tyre dhe japin arsyet pse janë përgjigjur në atë mënyrë, ndërsa mësimdhënësi i orienton drejt argumenteve që çojnë në përgjigjet e duhura. Gjatë një diskutimi të hapur, nxirret përfundimi se dërgimi mesazheve që fyejnë e kritikojnë dikë ose përmbajnë informacione të besueshme për dikë, paraqet një komunikim të papërgjegjshëm, sepse e lëndon personin të cilit i përket, pavarësisht nëse mesazhi arrin tek ai dhe/ose do ta kuptojnë të tjerët, të cilëve nuk u është dedikuar.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, tërheqin nga një fletë ku janë shkruar tri mesazhe me përmbajtje të ndryshme (secili grup pranon mesazhe të ndryshme): që shprehin lumturi, gëzim, kënaqësi (p.sh. *Kam atlete të reja.*), trishtim (p.sh. *Më vjen keq për macen tënde!*), zemërim (p.sh. *Për shkakun tënd mua më qortuan.*), dashuri (p.sh. *Sa i/e dashur që je!*), pajtueshmëri, përkrahje (p.sh. *Shkëlqyeshëm e bërë atë!*), shqetësim (p.sh. *Ende ke temperaturë?*) ose shaka, përmbajtje ironike (p.sh. Me kënaqësi e shkruaja detyrën e shtëpisë). Secili grup i shkruan mesazhet në telefonin celular, shton nga një emotikon të përshtatshëm dhe ua dërgon nxënësve të grupeve të tjera. Secili grup lexon mesazhet që ka pranuar, vizaton në tabelë emotikonin e përfshirë në mesazh dhe tregon se si e kanë përjetuar atë. Nëpërmjet diskutimit të përbashkët vërtetohet se cilat emotikone për cilin emocion janë përdorur dhe nxirret përfundimi se emocionin e njëjtë mund të shprehet me emotikon të ndryshëm.
- Mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse e dinë se çfarë është dhe për se shërben interneti, kurse nxënësit japin përgjigjet e tyre. Më pas,

mësimdhënësi vizaton një pemë të madhe me shumë degë në gjithë tabelën. Nxënësit shkruajnë në ngjitëse të veçanta (të paktën pesëdhjetë): kompjuter, tablet, telefon celular dhe i ngjitin në pemë si gjethe. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të imagjinojnë sikur pema përfaqëson një rrjet interneti – secila fletë e pemës është një kompjuter ose pajisje e mençur dhe se e gjithë shporta mund të ketë mijëra gjethe që janë të lidhura me degët me të cilat ato "komunikojnë" njëri me tjetrin (marrin dhe shpërndajnë informacione). Mandej u tregohet një "skemë" kompjuterësh të lidhur si rrjet në shkollë, në qytet, në gjithë botën dhe shpjegon se çdo informacion mund të transmetohet dhe të fitohet një shumëllojshmëri të dhënash nga çdo fushë nëpërmjet shfrytëzimit të internetit. Në fund, nxënësit ndajnë përvojat e tyre gjatë kërkimit në internet dhe thonë nëse kanë kërkuar vetë ose me ndonjë të rritur, çfarë kanë gjetur, çfarë kanë mësuar dhe çka duan më shumë të dinë rreth kërkimit në internet.

- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepen fletë letre të shkruara me tekste të ndryshme të shkurtra (një paragraf) për një temë të caktuar (p.sh. *"Kafshët e preferuara shtëpiake"*, *"Mjetet e transportit"*), me detyrë për t'i ndarë fjalët më të rëndësishme që u referohet fjalia/teksti (*kafshët shtëpiake, qen, mace, papagall, automjet, makinë, aeroplan etj.*). Pasi të ketë lexuar secili grup përgjigjet, me anë të një diskutimi të hapur nxirret përfundimi se fjalët e përzgjedhura konsiderohen fjalë kyçe, sepse ato përcjellin informacionin kryesor që përmban tekstin, domethënë tregojnë temën që trajton tekstin.
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një temë për të kërkuar në internet (p.sh. kafshë shtëpiake, mjete transporti ) me detyrë të përcaktojnë se çfarë duan të dinë rreth temës dhe cilat fjalë kyçe duhet të përdorin për të kërkuar në internet. Mësimdhënësi ua tregon hapat bazë të kërkimit: (1) hapet "kërkuesi Google" (2) shënohet saktë fjala kyçe ose kombinimi nga disa fjalë kyçe ose një pyetje e shkurtër në lidhje me informacionin që duan të zbulojnë, (3) klikohet "kërko" (search)" ose shtypet butoni "enter" dhe (4) hapen lidhjet që ofrojnë informacionin e kërkuar. Grupet shkruajnë informacionin e marrë për temën. Secili grup i tregon fjalët kyçe që ka kërkuar dhe para të tjerëve paraqet informacionin e marrë. Në një diskutim të hapur krahasohen fjalët kyçe, ose pyetjet e shkurtra që çdo grup i ka shfrytëzuar gjatë kërkimit dhe përcaktohet rëndësia e tyre për marrjen e informacionit të duhur.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, tërheqin nga një fletëz me nga dy përmbajtje - njëri informacion i dhënë nëpërmjet tekstit dhe informacioni tjetër i dhënë me një ilustrim /fotografi (fletëza të ndryshme për secilin grup). Për shembull, në një fletëz mund: (1) të shkruhet se një vajzë kishte një qen të zi si kafshë shtëpiake, ndërsa shoqja e saj kishte një akvarium me peshq, ku grupi duhet ta paraqesë tekstin me ilustrime/fotografi dhe (2) të paraqitet një ilustrim/fotografi me fëmijë gjatë një feste të ditëlindjes, për të cilën grupi duhet të shkruajë një tekst të shkurtër (5 fjali). Pas prezantimit të punës së bërë në grupe, nxënësit pyeten a e kishin më lehtë ta paraqesin situatën me tekst a me ilustrim/fotografi. Në fund, grupeve u jepet detyrë që me ndihmën e telefonave të vet të bëjnë një video të shkurtër (në të cilën ata vetë aktrojnë) dhe mjaft shkurt (me së paku 4 fjali) ta përshkruajnë situatën që është paraqitur në të. Secili grup prezanton para të tjerëve punën e realizuar.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, me tërheqjen e një flete zgjedhin një temë (p.sh. *"Ndjenjat që lindin gjatë përjetimit të suksesit"*, *"Shmangia e situatave të rrezikshme me persona të panjohur"*, *"Transmetimi i sëmundjeve infektive të fëmijët"*) për të cilën duhet të krijojnë përmbajtje

mediatike të përbërë nga një tekst i shkurtër që vetë do ta mendojnë dhe me fotografi ose video-incizime që do t'i përgatisin vetë. Teksti nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 fjali, ndërsa fotografitë dhe incizimet mund t'i bëjnë duke përdorur telefonin celular dhe vetë si pjesëmarrës që "aktojnë" në një situatë të caktuar. Secili grup prezanton para të tjerëve punën e bërë.

## GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet kyçjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohtë dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/ përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërthrin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi i ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënësi. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione prapavepruese të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- punimet e nxënësve (krijime, deklaratat etj.);
- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- përgjigjet e dhëna në fletëzat e punës;



- realizimet praktike (të lexuarit, të shkruarit);
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies.

Vlerësimi sumativ kryhet në bazë të të dhënave të përgjithshme të përfituara nga përcjellja e arritjeve të nxënësit dhe nga vlerësimi formativ, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, ku mësimdhënësi konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të të arriturave për çdo nxënës veçmas, në kuadër të secilës fushë programore. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative përshkruese.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	Viti _____ 2023/2024 _____
<b>Institucioni/bartës i programit</b>	Byroja e zhvillimit të arsimit Биро за развој на образование
<p><b>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), Ministri i arsimit dhe shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën III.</b></p> <p><b>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик</i> за III одделение.</b></p>	<p>бр. 12-14698/5 5.12.2022 година</p> <p style="text-align: right;">Ministër i Arsimit dhe Shkencës Doc. Dr. Jeton Shaqiri</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/>